



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M K.P.P. 457/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.07.2019 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. *REF-14845-03-21-2019*, me objekt: “*Shërbime fotokopje me të tretët*”, me fond limit 9.761.975,33 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.”
- Ankimues:** “Infosoft Office” sh.p.k.
Autostrada Tiranë – Durrës, Km.8, Kashar, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.
Rruga “Kavajës”, Ndërtesa Nr.133, Njësia Administrative Nr.6, Kodi Postar 1027, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.03.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-14845-03-21-2019, me objekt: “*Shërbime fotokopje me të tretët*”, me fond limit 9.761.975,33 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 06.05.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 13.05.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|--|
| 1. “Infosoft Office” sh.p.k. | 7,11 lekë (për njësi), skualifikuar |
| 2. BOE “PC Store” sh.p.k. & “Ricon-AI” sh.p.k. | 54,70 lekë (për njësi), kualifikuar |
| 3. “Erisony Company” sh.p.k. | 56,82 lekë (për njësi), skualifikuar |
| 4. “BNT Electronics” sh.p.k. | 8,890,000 lekë (për njësi), skualifikuar |

II.4. Në datën 13.05.2019, operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

“Së pari AK në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të kualifikimit/kapaciteti teknik pika 7 si më poshtë cituar:

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese katalogun/et ose broshura të prodhuesit/ve te pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit .Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specififikimet teknike të produkteve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik Infosoft Office nuk ka arritur të paraqesë katalogje apo broshurë për të gjitha produktet që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur KVO vëren se operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë broshura apo katalogje për pajisjet”Printer,Formati A4-Bardh e Zi” sasia 20 copë ,pajisje e kërkuar në fq.39 të DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumenta, pasi një operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor. Mungesa e katalogut apo broshurës për pajisjet printer Formatit A4-Bardh e Zi” sasia 20 copë e bën të pamundur identifikimin e plotësimin të specififikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor.

Në këto kushte mungesa e dokumentacionit të kërkuar dhe për rrjedhojë mungesa e specififikimeve teknike për pajisjen e sipërcituar nuk lejon kryerjen dhe verifikimin e specififikimeve teknike të pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit, gjë kjo e cila do të shërbente si garanci për autoritetin kontraktor, për përmbushjen me sukses të objektit të prokuruar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

KVO-ja thekson se nuk jemi në rastin e parashikuar nga neni 45 i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar që AK të kërkonte shpjegime apo verifikime mbi vërtetësinë e dokumentave të paraqitur, por jemi në kushtet e mungesës së dokumentave të kërkuar në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Në shtojcën 8 të DST shprehimisht citohet se Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik 3.3 në të cilën është kërkuar si më poshtë vijon:

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 3,904,790(tre milion e nëntëqind e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë)lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit(përlllogaritur nga data e zhvillimit të tenderi) Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

3.1.Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes të nënshkruar nga të dyja palët ku të shenohen datat, shumat dhe llojet e shërbimeve.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në pikën 3.3 operatori ekonomik ka paraqitur kontratën nr.24/4 datë 17.06.2016 me objekt "Shërbim Printim Fotokopjimit" nënshkruar me Drejtorinë e Policisë së Shtetit" me vlerë 11,788,271 lekë me tvsh nga të cilat evidentohet se është fotokopje e pa noterizuar, e cila bie në kundërshtim me dokumentacionin të përcaktuar në DST në të cilën shprehimisht citohet se: "Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Vlen të theksojmë se në manualin nr.1 datë 26.01.2018" Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimeve elektronike" citohet se Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik do të konsiderohet i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit."

II.5. Operatori ekonomik "Infosoft Office" sh.p.k. në datën 17.05.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me pretendimet si më poshtë vijon:

[...] Lidhur me arsyen e parë për të cilën jemi skualifikuar: "Së pari AK në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të kualifikimit/kapaciteti teknik pika 7 si më poshtë cituar: 7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose broshura të prodhuesit/ve të pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit .Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produkteve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik Infosoft Office nuk ka arritur të paraqesë katalogje apo broshurë për të gjitha produktet që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur KVO vëren se operatori ekonomik "Infosoft Office" sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë broshura apo katalogje për pajisjet"Printer,Formati A4-Bardh e Zi" sasia 20 copë ,pajisje e kërkuar në fq.39 të DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumenta, pasi një operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti

kontraktor. Mungesa e katalogut apo broshurës për pajisjet printer Formati A4-Bardh e Zi” sasia 20 copë e bën të pamundur identifikimin e plotësisht të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor. Në këto kushte mungesa e dokumentacionit të kërkuar dhe për rrjedhojë mungesa e specifikimeve teknike për pajisjen e sipërcituar nuk lejon kryerjen dhe verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit, gjë kjo e cila do të shërbente si garanci për autoritetin kontraktor, për përmbushjen me sukses të objektit të prokuruar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. KVO-ja thekson se nuk jemi në rastin e parashikuar nga neni 45 i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” I ndryshuar që AK të kërkonte shpjegime apo verifikime mbi vërtetësinë e dokumentave të paraqitur, por jemi në kushtet e mungesës së dokumentave të kërkuar në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST. Në shtojcën 8 të DST shprehimisht citohet se Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”

Për të plotësuar kërkesën tuaj për pajisjet printer format A4 bardh e zi 20 copë, është ofertuar modeli Lexmark X464 I cili përmbush dhe tejkalon kërkesat tuaja për printer format A4 bardh e zi. Për këto pajisje kemi paraqitur katalogun përkatës të emërtuar “Katalog me specifikimet ne shqip Lexmark X464”. Ju keni kërkuar edhe printera A4 bardh e zi, edhe pajisje multifunkionale A4. Për të dyja këta zëra, ne kemi ofertuar pajisjet Lexmark X464 që janë (sic e shihni dhe ne katalog) pajisje shumë funksionale, dhe njëkohësisht edhe printera A4 bardh e zi, gjë që ju kemi sqaruar edhe tek Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike. Në këtë deklaratë ju kemi sqaruar me detaje se çfare modeli pajisje kemi ofertuar për çdo zë të kërkuar nga ju. Bashkëngjitur gjeni një printim të faqes së APP ku kemi nënvizuar katalogun në fjale. Pra kjo arsye nuk qëndron pasi e kemi paraqitur katalogun e kërkuar.

2. Lidhur me arsyen e dytë për të cilën jemi skualifikuar:

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik 3.3 në të cilën është kërkuar si më poshtë vijon: Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 3,904,790(tre milion e nëntëqind e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë)lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit(përlllogaritur nga data e zhvillimit të tenderi) Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

3.1.Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes të nënshkruar nga të dyja palët ku të shenohen datat, shumat dhe llojet e shërbimeve. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në pikën 3.3 operatori ekonomik ka paraqitur kontratën nr.24/4 datë 17.06.2016 me objekt ”Shërbim Printim Fotokopjimit” nënshkruar me Drejtorinë e Policisë së Shtetit” me vlerë 11,788,271 lekë me tvsh nga të cilat evidentohet se është fotokopje e pa noterizuar, e cila bie në kundërshtim me dokumentacionin të përcaktuar në DST në të cilën shprehimisht citohet se: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Vlen të theksojmë se

në manualin nr.1 datë 26.01.2018”Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimeve elektronike”citet se Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar. Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik do të konsiderohet i pavlefshëm. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kontrata e paraqitur nga ana jonë është origjinale, por materiali i skanuar kishte kapacitet shume te madh dhe faqja e APP nuk lejonte ngarkimin e saj, pasi sic e dini pranon dokumenta deri në 30 MB. Për këtë arsye u detyruam të bëjmë optimizim të materialit (gje qe e shikoni edhe nga prapashtesa opt që ka marrë emërtimi i materialit: Kontrata DPSSH_opt.pdf) për të ulur kapacitetin në mënyrë që të mund ta ngarkonim në faqe. Kjo gjë ka cuar në uljen e cilësisë së ngjyrave dhe kontrata duket si kopje. Kjo nuk mund të jetë një arsye për skualifikim, referuar edhe nenit 53 të LPP, pika 4 [...], ky mund të konsiderohet një devijim i vogël aq më tepër që edhe kërkesa juaj për paraqitje kontrate është në kapërcim të ligjit. Referuar VKM 914, neni 28, pika 3 thuhet [...].

Kërkesa juaj: “Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 3,904,790(tre milion e nëntëqind e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë)lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit(përlllogaritur nga data e zhvillimit të tenderi).

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

3.1. Kur shërbimi i ngjashem është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetoje duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate”, për të paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin është në shkelje dhe në kapërcim të ligjit. Ligji ju lejon të kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent public ose/dhe faturave tatimore të shitjes, por jo kontratën. Vërtetimi i paraqitur nga ana jonë është original. Bazuar në sa thamë më sipër, e konsiderojmë të padrejtë skualifikimin e ofertës tonë dhe në shkelje të LPP, aq më tepër që bëhet fjalë për një ofertë disa herë më të ulët se sa oferta e renditur e dyta. Bazuar në nenin 63 të LPP po paraqesim këtë ankese, duke kërkuar klasifikimin sit ë rregullt të ofertës sonë, pasi kemi përmbushur të gjitha kërkesat e kësaj procedure.

II.6. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor si dhe dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor në datën 20.05.2019, me anë të shkresës nr.9369/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë. Operatori ekonomik ankimues pretendon se ka marrë dijëni në lidhje me refuzimin e ankesës së tij në datë 21.05.2019. Konkretisht, në kthim përgjigje, autoriteti kontraktor ka argumentuar si më poshtë vijon:

“[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim procesverbalin e vlerësimit të mbajtur nga KVO verën se operatori ekonomik është skualifikuar me arsyetimin e mëposhtem: Se pari operatori ekonomik Infosoft Office është skualifikuar për shkak se nuk ka arritur të paraqesë broshura apo katalogje për pajisjet "Printer, Formati A4-Bardh e Zi" sasia 20 cope pajisje e kërkuar në fq. 39 të DST.

Se dyti kontrata e paraqitur nga operatori ekonomik nr Prot 24/4 date 17.06 2016 me objekt "Sherbim Printim Fotokopjim" nënshkruar me Drejtorinë e Policisë së Shtetit me vlerë 11,788,271 leke me tvsh nga të cilat evidentohet se është fotokopje e pa noterizuar, e cila bie në kundërshtim me dokumentacionin të përcaktuar në DST në të cilën shprehimisht citohet se: "Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Në ankesën e paraqitur pranë UKT shpallësi operatori ekonomik pretendon se për të plotësuar kriterin për pajisjet printer format A4 Bardh e Zi sasia 20 copë pajisje kemi paraqitur pajisjet Lexmarx X464 të cilat janë shumëfunktionale.

Se pari KSHA pasi mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik citon se: Kriteret për kualifikim vendosen që të shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike, të cilat, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi shqyrtoi dokumentacionin e operatorit ekonomik në sistemin elektronik konstatoi se operatori ankimes nuk ka arritur të paraqesë katalogje apo broshura për pajisje printer A4 Bardh e Zi ashtu siç dhe operatori ekonomik pranon në ankesën e paraqitur pranë UKT shpallësi se printerat e ofruara për shërbim janë multifunktionale.

Sqarojmë operatorin ekonomik se pajisja e kërkuar në DST nga AK është printer format A4 Bardh e Zi dhe për rrjedhojë operatori ekonomik ka qenë i detyruar të paraqesë katalogje për printer format A4 Bardh e Zi.

Citojmë se KVO në vlerësimin e kryer e ka konsideruar të plotësuar paraqitjen e katalogjeve X464 për pajisjet multifunktionale (sasia 15 copë).

AK ka kërkuar 20 pajisje printimi për përdorim brenda zyrave duke parashikuar hapësirën e vogël të zënë nga ato si dhe përvojën vetem për të printuar nga stafit brenda zyrës ku do vendoset pajisja. Parashikimi nga ana jone për të kërkuar këto pajisje vetem për printim ka ardhur si rezultat i mungesës së hapësirës fizike (në tavolinat e përgjegjësve perkates) si dhe duke parashikuar fluksin dhe llojin e punës së stafit që do të përdoren këto pajisje. Kjo kërkesë nuk ka ardhur për të kufizuar operatorët ekonomike në procedurën objekt prokurimi por është thjesht si rrjedhojë e kapaciteteve fizike të shoqërisë. Përsa me sipërpretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk pranohet.

Se dyti në ankesën e paraqitur pranë UKT shpallësi operatori ekonomik pretendon se kontrata e paraqitur është origjinale por duke qenë se materiali i skanuar kishte kapacitet të madh u detyruan të bëjnë optimizim të materialit në mënyrë që ta ngarkonin në faqe dhe për rrjedhojë ka cuar në uljen e cilësive së ngjyrave dhe kontrata duke si kopje. Akoma me tej në ankesën e paraqitur operatori ekonomik pretendon se vendosja e kërkesës së AK për të paraqitur kontratë të ngjashme është në kapërcim dhe në shkelje të ligjit. Ligji ju lejon të kerkoni vërtetime të leshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes për jo kontratën. Referuar pretendimit tuaj se AK nuk duhet të kerkonte kontratë të ngjashme në DST theksojmë se nuk kemi paraqitur asnjë kërkesë për sqarim apo ankese drejtuar AK lidhur me këto kriter për kualifikim sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në DT. Për çdo pretendim për kriteret për kualifikim nëse janë apo jo të mbështetura në ligjin e prokurimit operatori nuk mund të ngrejë në këto faze të prokurimit kur ka skaduar çdo afat i paraqitjes së tyre. Për pretendimet për kriteret për kualifikim ankimesi duhet

te kishte vepruar referuar percaktimeve te nenit 63, pika 1.1 si dhe nenit 63 pika 6 te ligjit nr 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" ku shprehimisht thuhet [...].

Mosrespektimi i ketij detyrimi ligjor ka bere qe ankimesi te humbe te drejten te ngreje pretendime per DT ne fazen e vleresimit te ofertave. Se dyti referuar pretendimit te ankimesit se kontrata nuk eshte fotokopje dhe se operatori ka qene detyruar te bente optimizim te materialit pasi materiali ka kapacitet me te madh se 30 MB sqarojme se: Eshte detyre dhe pergjegjesi e operatori ekonomik per paraqitjen dhe hedhjen e dokumentacionit te plote, te sakte si dhe forma e dokumentacionit te cilet duhet te dorezoje operatori ekonomik ne sistemin elektronik duhet te jete origjinale ose kopje te noterizuara me origjinalin. Citojmë se jo domosdoshmerisht duhet të ngarkoni materialin ne nje "file" te vetme por sistemi elektronik ju jep mundesine qe nje dokument (rasti konkret kontraten e ngjashme) edhe ne rastin kur ka kapacitet më te madh se 30 MB mund ta ngarkoni ne disa file duke e paraqitur ate ne formen origjinale apo te kopje te njehsuar me origjinalin. Per sa me siper pretendimi juaj nuk qendron dhe per rrjedhoje nuk pranohet.

II.7. Në datën 28.05.2019 operatori ekonomik "Infosoft Office" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...] Lidhur me arsyen e pare te skualifikimit [...]

Sqaruar AK se per te plotësuar kërkesën tuaj për pajisjet printer format A4 bardh e zi 20 copë, kemi ofertuar modeli Lexmark X464 I cili përmbush dhe tejkalon kërkesat për printer format A4 bardh e zi. Për këto pajisje kemi paraqitur katalogun përkatës të emertuar "Katalog me specifikimet ne shqip Lexmark X464". Në këtë procedure jane kërkuar edhe printera A4 bardh e zi, edhe pajisje multifunksionale A4. Për të dyja këta zëra, ne kemi ofertuar pajisjet Lexmark X464 që janë (sic e shihni dhe ne katalog) pajisje shumë funksionale, dhe njëkohësisht edhe printera A4 bardh e zi, gjë që jua kemi sqaruar edhe tek Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike. Në këtë deklaratë kemi sqaruar me detaje se cfare modeli pajisje kemi ofertuar për cdo zë të kërkuar në këtë procedure.

AK na përgjigjet se:

Sqarojme operatorin ekonomik se pajisja e kerkuar ne DST nga AK eshte printer format A4 Bardh e Zi dhe per rjedhoje operatori ekonomik ka qene i detyruar te paraqese katalogje per printer format A4 Bardh e zi. Citojme se KVO ne vleresimin e kryer e ka konsideruar te plotesuar paraqitjen e katalogjeve X464 per pajisjet multifunksionale (sasia 15 cope). AK ka kerkuar 20 pajisje printimi per perdorim brenda zyrave duke parashikuar hapesiren e vogel te zene nga to si dhe nevojën vetem per te printuar nga stafi brenda zyres ku do vendoset pajisja.

Parashikimi nga ana jone per te kerkuar keto pajisje vetem per printim ka ardhur si rezultat i mungeses se hapesires fizike (ne tavolinat e pergjegjesve perkates) si dhe duke parashikuar fluksin dhe llojin e punes se stafit qe do te perdore kete pajisje. Kjo kerkese nuk ka ardhur per te kufizuar operoret ekonomike ne procedure objekt prokurimi por eshte thjesht si rrjedhoje e kapaciteteve fizike te shoqerise. Persa me siperpretendimii operatori ekonomik nuk qendron dhe per rrjedhoje nuk pranohet.

Theksojmë se:

Kerkesa e AK ishte per "pajisjet printer format A4 bardh e zi 20 cope", dhe ne kemi ofertuar printera shume funksionale, pra kemi permbushur dhe tejkalar kerkesen, duke ofertuar pajisje me specifikime teknike me te larta sesa eshte kerkuar, por kjo nuk eshte arsye per skualifikim. Mosplotesimi i kerkesave te procedures eshte arsye per skualifikim, jo tejkalimi. Referuar VKM

per Rregullat e Prokurimit Publik Nr.914, date 29.12.2014, Neni 27, Kontratat e mallrave, ku thuhet: [...].

Specifikimet duhet te shprehin elemente minimale te kerkesave teknike. Produkti i ofertuar nga OE, e tejkalon kete minimum te kerkuar, gje e cila as nga AK nuk kundershohet. E konsiderojme jo te drejte dhe te cuditshem nje mospranim te nje produkti qe i tejkalon kerkesat dhe pritshmerite e AK. Mendojme se AK eshte ne shkelje te VKM per Rregullat e Prokurimit Publik Nr 914. date 29.12.2014, Neni 27, cituar me lart. Ky ka qene edhe nje nga qendrimet e KPP ne procedura ekuivalente. Lidhur me hapësirën që zënë pajisjet, argument që e permend AK ne pergjigjen e tij, sqarojmë se fakti që pajisjet jane shume funksionale nuk do te thote që jane me permasa fizike me te medha se printerat e thjeshte. Perkundrazi, me specifikimet e kerkuara ne tender mund te kishim ofertuar printera te thjeshte që kane permasa shume me te medha se pajisjet shume funksionale Lexmark X464 që kemi ofertuar, dhe perseri AK nuk mund te na skualifikoje per kete ceshnje, pasi ne DST nuk ishte percaktuar asgje ne lidhje me permasat fizike te pajisjeve. Nese AK kishte probleme me hapësirën e lire, krahas specifikimeve teknik, duhej te kishte percaktuar ne DST permasat e lejuara per pajisjet. Ne DST ishin percaktuar disa specifikime teknike per "pajisjet printer format A4 bardh e zi 20 cope" dhe ne i kemi plotesuar ato te gjitha duke ofertuar pajisje Lexmark X464, por sic e shihni me poshte nuk eshte dhene asnje specifikim per permasat fizike te pajisjes:

Sasia 20 cope pajisje

<i>Pajisje printer Formati – A4 – Bardh e zi</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/Bardhe zi</i>
<i>Shpejtesia</i>	<i>Jo me e vogel 40 faqe/min</i>
<i>Resolucioni i printimit</i>	<i>Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi</i>
<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve</i>	<i>Jo me i vogel 500 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje</i>	<i>Jo me i vogel 300 faqe</i>
<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A4</i>
<i>Memorja</i>	<i>512 MB</i>
<i>Lidhja</i>	<i>Ethernet, USB</i>
<i>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</i>	<i>Po</i>

Vete AK ne pergjigjen e tij ndaj ankeses tone pohon që ky katalog eshte paraqitur nga ana jone. Atehere cilin specifikim apo kerkese te percaktuar ne DST lidhur me keto pajisje nuk kemi plotesuar?

Lidhur me arsyen e dyte te skualifikimit [...]

Sqaruar AK se: Kontrata e paraqitur nga ana jonë është origjinale, por materiali i skanuar kishte kapacitet shume te madh dhe faqja e APP nuk lejonte ngarkimin e saj, pasi sic e dihet pranon dokumenta deri në 30 MB. Për këtë arsye u detyruam të bëjmë optimizim të materialit (gje që e shikoni edhe nga prapashtesa opt që ka marrë emërtimi i materialit: Kontrata DPPSH_opt.pdf) për të ulur kapacitetin në mënyrë që të mund ta ngarkonim në faqe. Kjo gjë ka cuar në uljen e cilësisë së ngjyrave dhe kontrata duket si kopje. Kjo nuk mund të jetë një arsye për skualifikim,

referuar edhe nenit 53 të LPP, pika 4 [...], ky mund të konsiderohet një devijim i vogël aq më tepër që edhe kërkesa Ak për paraqitje kontrate është në kapërcim të ligjit. Referuar VKM 914, neni 28, pika 3 thuhet [...].

Kërkesa e AK: “Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 3,904,790(tre milion e nëntëqind e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë)lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit(përlllogaritur nga data e zhvillimit të tenderi).

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

3.1. Kur shërbimi i ngjashem është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate”, për të paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin është në shkëlqje dhe në kapërcim të ligjit. Ligji lejon të kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent public ose/dhe faturave tatimore të shitjes, por jo kontrata. Vërtetimi i paraqitur nga ana jonë është original.

AK na përgjigjet se: Referuar pretendimit tuaj se AK nuk duhej të kerkonte kontrate të ngjashme në DST theksojmë se nuk keni paraqitur asnjë kerkese për sqarim apo ankese drejtuar AK lidhur me këto kriter për kualifikim sipas procedurës dhe afateve të percaktuara në DT. Për çdo pretendim për kriteret për kualifikim nëse janë apo jo të mbështetura në ligjin e prokurimit operatori nuk mund të ngrejë në këto faze të prokurimit kur ka skaduar çdo afat i paraqitjes së tyre. Për pretendimet për kriteret për kualifikim ankuesi duhet të kishte vepruar referuar percaktimeve të nenit 63, pika 1.1 si dhe nenit 63 pika 6 të ligjit nr 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” ku shprehimisht thuhet [...].

Mosrespektimi i këtij detyrimi ligjor ka bërë që ankuesi të humbë të drejtën të ngrejë pretendime për DT në fazën e vlerësimit të ofertave. Se dyti referuar pretendimit të ankuesit se kontrata nuk është fotokopje dhe se operatori ka qenë detyruar të bënte optimizim të materialit pasi materiali ka kapacitet më të madh se 30 MB sqarojmë se: Është detyrë dhe përgjegjësi e operatori ekonomik për paraqitjen dhe hedhjen e dokumentacionit të plote, të sakte si dhe forma e dokumentacionit të cilet duhet të dorëzojë operatori ekonomik në sistemin elektronik duhet të jetë origjinale ose kopje të noterizuara me origjinalin. Citojmë se jo domosdoshmërisht duhet të ngarkoni materialin në një “file” të vetme por sistemi elektronik ju jep mundësinë që një dokument (rasti konkret kontratën e ngjashme) edhe në rastin kur ka kapacitet më të madh se 30 MB mund ta ngarkoni në disa file duke e paraqitur atë në formën origjinale apo të kopje të njehsuar me origjinalin. Për sa me sipër pretendimi juaj nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk pranohet.

Lidhur me argumentimin e AK, për mosparaqitje të një kerkese për sqarim apo ankese në afatin e percaktuar, sqarojmë se kompania jone disponon kontrata të shumta me objekt shërbim printimi, të realizuara me sukses dhe prandaj nuk e gjykojmë të arsyeshme ta kundërshtojmë këto kerkese. Tani duke qenë se jemi në kushtet e një problemi teknik, kërkojmë që perderisa VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 28, Kontratën e shërbimeve, pika 3, sheh të mjaftueshme paraqitjen e vërtetime të lëshuara nga një ent public ose/dhe faturave tatimore të shitjes si dëshmi për përvojën e mëparshme edhe vërtetimi paraqitur nga ana jone të konsiderohet i mjaftueshem për të bindur AK se kemi përvojën të mëparshme të ngjashme. Gjithsesi e kemi paraqitur edhe kontratën e kërkuar, por zvogëlimi i kapacitetit të dokumentit, i ka ulur cilësinë duke e bërë të duket si fotokopje. Si provë, bashkë me këto ankese, po ju paraqesim edhe kontratën origjinale. Referuar nenit 53 të LPP, Shqyrtimi i ofertave, pika 4:

“Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristika, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigjohen pa prekur permbajtjen e saj”, ky mund te konsiderohet nje devijim i vogel, pasi nuk ndryshon asnje karakteristike, kusht apo kerkese te percaktuara ne DST. Bazuar ne sa thame me siper dhe ne nenin 63 te LPP po paraqesim kete kerkes, duke kerkuar klasifikimin sit e rregullt te ofertes sone.

II.8. N p ermjet shkres s nr. K-1573/1 prot., dat  06.06.2019, protokolluar me ton n n  dat n 10.06.2019, me objekt “D rgim informacioni n  lidhje me zhvillimin e procedur s s  prokurimit me objekt “Sh rbim fotokopje me t  tret ”,  sht  deponuar n  Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedur n e m sip rme t  prokurimit dhe trajtimin e ankes s s  operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit t  ankes s, dokumentacionit bashk ngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit t  autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit t  ofert s s  tij ekonomike “...S  pari AK n  dokumentat standart  t  tenderit tek Kriteret e Veçanta t  kualifikimit/kapaciteti teknik pika 7 si m  posht  cituar:

7. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et ose broshura t  prodhuesit/ve te pajisjeve q  do t  sh rbejn  p r kryerjen e proçesit t  sh rbimit .N  rast se katalogjet apo broshurat jan  n  gjuh  t  huaj at her  duhet t  paraqiten t  p rkthyerat n  gjuh n shqipe.Katalogu ose broshura duhet t  ket  t  detajuar specifikimet teknike t  produkteve q  do t  sh rbejn  p r kryerjen e proçesit t  sh rbimit. Gjat  shqyrtimit t  dokumentacionit n  sistemin elektronik Komisioni i Vler simit t  Ofertave konstaton se operatori ekonomik Infosoft Office nuk ka arritur t  paraqes  katalogje apo broshur  p r t  gjitha produktet q  do t  sh rbejn  p r kryerjen e proçesit t  sh rbimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit t  paraqitur KVO v ren se operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k nuk ka arritur t  paraqes  broshura apo katalogje p r pajisjet “Printer,Formati A4-Bardh e Zi” sasia 20 cop  ,pajisje e k rkuar n  fq.39 t  DST.

Komisioni i Vler simit t  Ofertave v ren se nuk jan  p rmbushur t  gjitha k rkesat q  autoriteti kontraktor ka p rcaktuar n  k to dokumenta, pasi n j operator ekonomik pjes marr s n  n j proçedur  prokurimi  sht  i detyruar t  plot soj  çdo k rkes  dhe kriter t  vendosur nga autoriteti kontraktor. Mungesa e katalogut apo broshur s p r pajisjet printer Formatit A4-Bardh e Zi” sasia 20 cop  e b n t  pamundur identifikimin e plot simit t  specifikimeve teknike sipas p rcaktimeve t  autoritetit kontraktor.

N  k to kushte mungesa e dokumentacionit t  k rkuar dhe p r rrjedhoj  mungesa e specifikimeve teknike p r pajisjen e sip rcituar nuk lejon kryerjen dhe verifikimin e specifikimeve teknike t 

pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit, gjë kjo e cila do të shërbente si garanci për autoritetin kontraktor, për përmbushjen me sukses të objektit të prokuruar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

KVO-ja thekson se nuk jemi në rastin e parashikuar nga neni 45 i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" I ndryshuar që AK të kërkonte shpjegime apo verifikime mbi vërtetësinë e dokumentave të paraqitur, por jemi në kushtet e mungesës së dokumentave të kërkuar në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Në shtojcën 8 të DST shprehimisht citohet se Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Për kapacitetin teknik”, pika 7, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose broshura të prodhuesit/ve të pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit. Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produkteve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit.

III.1.2. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 11, “Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

[...]

Shërbimi që kërkohet:

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia/Fletët e Pritshme
1	Shërbim Printim/fotokopjim bardhe e zi A4	cope	3,700,000
2	Shërbim Printim/fotokopjim me ngjyra e zi A4	cope	100,000
3	Shërbim Printim/fotokopjim bardhe e zi A3	cope	70,000
4	Shërbim Printim/fotokopjim me ngjyra e zi A3	cope	70,000
5	Shërbim Printim Ploter	cope	3,000

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër

III.1.3. Ndërkohë në Shtojcën 12, “Termet e Referencës”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

- Sasia 5 Cope paisje

<i>Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner)</i> <i>Formati – A3 - Bardh e zi</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/Bardhe zi</i>
<i>Shpejtesia</i>	<i>Jo me e vogel 50 faqe/min</i>
<i>Resolucioni i printimit</i>	<i>Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi</i>
<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve</i>	<i>Jo me i vogel 2000 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje</i>	<i>Jo me i vogel 500 faqe</i>
<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A3</i>
<i>Memorja</i>	<i>2 GB / 320 GB HDD</i>
<i>Lidhja</i>	<i>Ethernet, USB</i>
<i>Skanimi</i>	<i>Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)</i>
<i>ARDF</i>	<i>50 faqe</i>
<i>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</i>	<i>Po</i>

- *Sasia 8 Cope paisje*

<i>Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner)</i> <i>Formati – A3 - Bardh e zi</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/Bardhe zi</i>
<i>Shpejtesia</i>	<i>Jo me e vogel 30 faqe/min</i>
<i>Resolucioni i printimit</i>	<i>Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi</i>
<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve</i>	<i>Jo me i vogel 1500 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje</i>	<i>Jo me i vogel 500 faqe</i>
<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A3</i>
<i>Memorja</i>	<i>2 GB / 320 GB HDD</i>
<i>Lidhja</i>	<i>Ethernet, USB</i>
<i>Skanimi</i>	<i>Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)</i>
<i>ARDF</i>	<i>50 faqe</i>
<i>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</i>	<i>Po</i>

- *Sasia 15 Cope paisje*

<i>Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner)</i> <i>Formati – A4 – Bardh e zi</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/Bardhe zi</i>
<i>Shpejtesia</i>	<i>Jo me e vogel 30 faqe/min</i>
<i>Resolucioni i printimit</i>	<i>Jo me i vogel 600 x 600 dpi</i>

<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve</i>	<i>Jo me i vogel 300 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje</i>	<i>Jo me i vogel 200 faqe</i>
<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A4</i>
<i>Memorja</i>	<i>512 MB</i>
<i>Lidhja</i>	<i>Ethernet, USB</i>
<i>Skanimi</i>	<i>Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)</i>
<i>ARDF</i>	<i>30 faqe</i>
<i>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</i>	<i>Po</i>

- *Sasia 5 Cope paisje*

<i>Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner)</i> <i>Formati – A3 - Color</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/Me ngjyra</i>
<i>Shpejtesia</i>	<i>Jo me e vogel 30 faqe/min</i>
<i>Resolucioni i printimit</i>	<i>Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi</i>
<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve</i>	<i>Jo me i vogel 1500 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje</i>	<i>Jo me i vogel 500 faqe</i>
<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A3</i>
<i>Memorja</i>	<i>2 GB / 320 GB HDD</i>
<i>Lidhja</i>	<i>Ethernet, USB</i>
<i>Skanimi</i>	<i>Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)</i>
<i>ARDF</i>	<i>50 faqe</i>
<i>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</i>	<i>Po</i>

- *Sasia 20 Cope paisje*

<i>Pajisje printer</i> <i>Formati – A4 – Bardh e zi</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/Bardhe zi</i>
<i>Shpejtesia</i>	<i>Jo me e vogel 40 faqe/min</i>
<i>Resolucioni i printimit</i>	<i>Jo me i vogel 1200 x 1200 dpi</i>
<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve</i>	<i>Jo me i vogel 500 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje</i>	<i>Jo me i vogel 300 faqe</i>
<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A4</i>

Memorja	512 MB
Lidhja	Ethernet, USB
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po

Specifikimet te Softëare.

- *Te mundesoje menaxhim dhe konfigurim te paisjeve ne menyre te centralizuar.*
- *Te mundesoje menaxhim dhe konfigurim driverash ne menyre te centralizuar.*
- *Te mundesoje update te firmareve te pasijeve ne menyre te centralizuar dhe ne orare te paracaktuara.*
- *Te skanoj gjendjen e statusit te paisjeve ne menyre sistematike dhe te lajmerej ne rast problem ofruesin e sherbimit per problemin qe paisje shfaq dhe te lajmerej perseri ne momentin qe problemi zgjidhet.*
- *Te dergoj lajmerimet me email tek ofruesi I sherbimit dhe nje kopje te marresi I sherbimit.*
- *Te mundesoj raportim te detajuar mbi baze paisjesh, perdoruesish, departamentesh.*
- *Te mundesoje raportime periodike per sasine e printimeve/fotokopjimeve/skanimeve per secilen paisje dhe ne total.*
- *Te dergoj raport mbi konsumin e energjise nga secila paisje.*
- *Te ruaj ne database te gjithë historikun e skanimeve te statusit te paisjeve.*
- *Komunikimi ne rrjet duhet te behet permes protokollit SNMP V1/2/3.*
- *Cdo komunikim, informacion te marre apo nxjerre mbi statusin e paisjeve duhet te lajmerohet departamenti i IT mbi cdo aktivitet.*
- *Softëare duhet te punoj dhe menaxhohet nga nje qender e vetme.*
- *Vendi i kryerjes së shërbimeve: Drejtoria e Përgjithshme UKT sh.a*

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor, ka paraqitur:

- “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike” të nënshkruar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k, datë 17.04.2019
- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, konkretisht operatori ekonomik ka paraqitur modelin e ofruar për secilën pajisje të kërkuar nga autoriteti kontraktor.
- Katalog për pajisjen Lexmark X 464 (i përkthyer dhe i noterizuar)
- Katalog për pajisjen Lexmark MX 910 Series (i përkthyer dhe i noterizuar)
- Katalog për pajisjen Lexmark X 950Series (i përkthyer dhe i noterizuar)
- Katalog për pajisjen HP Designjet T2300 eMFP series (i përkthyer dhe i noterizuar)
- Broshurë Softëare menaxhim sistemi printimi

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.1.6. Ndërsa në nenin 53/3 të të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni,

vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.1.7. Në nënin 27, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin katalogun/et ose broshura të prodhuesit/ve të pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit. Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se katalogët ose broshurat duhet të kenë të detajuar specifikimet teknike të produkteve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, Katalogë të produkteve të ofruara, të përkthyer dhe të noterizuar, Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, duke paraqitur modelin që ofron për secilën pajisje të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

III.1.9. Referuar arsyes së skualifikimit, për sa kohë në kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, kërkohet shprehimisht që “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose broshura të prodhuesit/ve të pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit. Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe. Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produkteve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit”, KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve të kërkuar, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përpuethshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këto pajisje.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton se ky i fundit ka dorëzuar Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, në të cilën ka paraqitur modelin që ofron për secilën pajisje të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Konkretisht për “Pajisjen multifunksionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A4 – Bardh e zi (15 copë)” dhe

për “Pajisjen Printer Formati – A4 – Bardh e zi (20 copë)” deklaroi se ka paraqitur katalogun e prodhuesit Lexmark X464de.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., pretendimet e këtij të fundit, si dhe nga shqyrtimi i kërkesave në dokumentat e tenderit, KPP konstaton se, nga verifikimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për produktin “Pajisje Printer Formati – A4 – Bardh e zi (20 copë)” si dhe specifikimeve teknike të produktit të ofruar nga operatori ekonomik ankimues, konkretisht në katalogun Lexmark X464de, konstatohet se pajisja e ofruar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. nuk i plotëson të gjitha specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për pajisjen “Printer Formati – A4 – Bardh e zi (20 copë)”, pra produkti i ofruar nga operatori ekonomik ankimues, konkretisht e modelit Lexmark X464de, nuk është sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Akoma më tej, vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor në mënyrë të shprehur ka përcaktuar në dokumentat e tenderit se se katalogët ose broshurat e ofruara nga operatori ekonomik ankimues duhet të kenë të detajuar specifikimet teknike të produkteve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit.

Sa më sipër argumentuar, konstatojmë se, specifikimet teknike të produktit “Printer Lexmark X464de” të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin “Printer Formati – A4 – Bardh e zi”, duke mos plotësuar kështu kërkesat e autoritetit kontraktor.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

III.1.10. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. mbi arsyet e tjera të skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës

ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. *REF-14845-03-21-2019*, me objekt: “*Shërbime fotokopje me të tretët*”, me fond limit 9.761.975,33 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 952 Protokolli

Datë 28.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha